



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.28

2 prill

2012

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Akt normativ i KM nr.1, datë 30.3.2012	Për një ndryshim në ligjin nr. 10 418, datë 21.4.2011 “Për legalizimin e kapitalit dhe faljen e një pjese të borxhit tatimor dhe doganor”, të ndryshuar.....	1353
Vendim i GJK nr.13, datë 21.3.2012	Me objekt konstatimin e cenimit të së drejtës për proces të rregullt ligjor, si rezultat i mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr.871, datë 11.8.1995 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.....	1353
Vendim i GJK nr.16, datë 27.3.2012	Me objekt shfuqizimin, si të papajtueshëm me Kushtetutën, të vendimit nr. 41, datë 9.7.2010 të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda dhe i vendimit nr. 1068, datë 21.12.2010 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë (Dhomë Këshillimi).....	1359
Vendim i GJK nr.17, datë 27.3.2012	Me objekt: - Shfuqizimin si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, të shprehjes “...ose në sektorët e veçantë të përcaktuar në këtë vendim apo në udhëzimet e Ministrisë së Financave”, të parashikuar në pikat 1 dhe 6.2 të VKM-së nr.96, datë 17.2.2010 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.781, datë 14.11.2007 “Për karakteristikat teknike e funksionale të pajisjeve fiskale, sistemit të integruar të kompjuterizuar për transformimet periodike, automatike, të deklarimeve financiare, sistemit të komunikimit, për procedurën e dokumentacionin për miratimin e tyre dhe për kriteret për pajisjen me autorizim të shoqërive të autorizuara për ofrimin e pajisjeve fiskale”;	

- Shfuqizimin, si të papajtueshme me Kushtetutën, të pikës 12 të udhëzimit nr.16, datë 3.5.2010 të Ministrit të Financave “Për administrimin dhe dokumentimin e procedurave të pajisjeve fiskale”;
- Pezullimin e zbatimit të fjalisë “...ose në sektorët e veçantë të përcaktuar në këtë vendim apo në udhëzimet e Ministrisë së Financave...” në pikat 1 dhe 6.2 të VKM-së nr.96, datë 17.2.2010 dhe pezullimi i pikës 12 të udhëzimit nr.16, datë 3.5.2010 të Ministrit të Financave.....

**AKT NORMATIV
Nr.1, datë 30.3.2012**

**PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR. 10 418, DATË 21.4.2011 “PËR LEGALIZIMIN E
KAPITALIT DHE FALJEN E NJË PJESE TË BORXHIT TATIMOR DHE DOGANOR”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në ligjin nr.10 418, datë 21.4.2011 “Për legalizimin e kapitalit dhe faljen e një pjese të borxhit tatimor dhe doganor”, të ndryshuar , bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Në pikën 1 të nenit 27, shprehja “... brenda kohës së zbatimit të këtij ligji ...”, zëvendësohet me shprehjen “... brenda datës 31.8.2012 ...”.

Neni 2

Në nenin 35, pas fjalisë së parë, shtohet një fjali, me këtë përmbajtje:
“Rivlerësimi i pasurisë së paluajtshme nga individët, në përputhje me nenin 27 të këtij ligji, mund të realizohet deri në datën 31.8.2012.”.

Neni 3

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI
Sali Berisha**

**VENDIM
Nr.13, datë 21.3.2012**

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Vladimir Kristo	Anëtar i “ “
Petrit Ploçi	Anëtar i “ “
Vitore Tusha	Anëtare e “ “
Sokol Berberi	Anëtar i “ “
Admir Thanza	Anëtar i “ “
Altina Xhoxhaj	Anëtare e “ “
Fatmir Hoxha	Anëtar i “ “

me sekretare Enina Mullaj, në datën 1.12.2011, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore, mbi bazë dokumentesh, çështjen nr. 51/26 Akti, që i përket:



KËRKUES: Hasan Buci

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Shërbimi Përbarimor Gjyqësor Dibër

Ndërmarrja e Shërbimit Pyjor Dibër

OBJEKTI: Konstatimi i cenimit të së drejtës për proces të rregullt ligjor, si rezultat i mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr.871, datë 11.8.1995 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

BAZA LIGJORE: Nenet 131/f dhe 142/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Fatmir Hoxha, shqyrtoi çështjen mbi aktet dhe diskutoi për të në tërësi,

VËREN:

I

1. Me vendimin nr.871, datë 11.8.1995, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër ka pranuar padinë e paditësit Hasan Buci, duke vendosur detyrimin e palës së paditur, Ndërmarrja e Shërbimit Pyjor Peshkopi, t'i shlyejë atij shumën 109 000 (njëqind e nëntë mijë) lekë. Ky vendim ka marrë formë të prerë në datën 24.8.1995.

Me kërkesën e datës 12.10.1995, kërkuesi i është drejtuar Zyrës Përbarimore Dibër për ekzekutimin e vendimit gjyqësor.

Me vendimin e datës 27.9.2004, Zyra Përbarimore Dibër ka vendosur pushimin e ekzekutimit, për arsye se debitori nuk ka gjendje në llogari.

2. Me vendimin nr.14, datë 10.3.2006, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër ka lëshuar urdhrin e ekzekutimit të vendimit nr.871, datë 11.08.1995 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

Me kërkesën e datës 15.5.2006, kërkuesi i është drejtuar Zyrës Përbarimore Dibër për ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë.

Me vendimin e datës 22.12.2006, Zyra Përbarimore Dibër ka vendosur pushimin e ekzekutimit, për arsye se debitori nuk ka mjetet e nevojshme për të shlyer detyrimin.

3. Me kërkesën e datës 7.6.2007, kërkuesi i është drejtuar Zyrës Përbarimore Dibër për ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë.

Me shkresën e datës 7.6.2007, Zyra Përbarimore Dibër i ka dërguar debitorit lajmërim për ekzekutim vullnetar të detyrimit.

Me shkresën nr.161/1 prot., datë 14.6.2007, Drejtorja e Shërbimit Pyjor Dibër i është drejtuar Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse, në Ministrinë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, me kërkesë për çelje fondesh për shlyerjen e detyrimit.

Në datën 21.6.2007 Zyra Përbarimore Dibër ka mbajtur një procesverbal të veprimeve përbarimore gjatë ekzekutimit, sipas të cilit debitori është shprehur se do ta shlyejë kreditorin në muajin shtator 2007.

Me shkresën nr.231 prot., datë 21.6.2007, Zyra Përbarimore Dibër i është drejtuar Degës së Thesarit Dibër për kërkim të dhënash lidhur me gjendjen financiare të debitorit.

Me shkresën nr.20/4 prot., datë 22.06.2007, dega e thesarit Dibër i përgjigjet Zyrës Përbarimore Dibër se debitori nuk ka fonde të planifikuara për përballimin e vendimeve gjyqësore për vitin 2007 (ku përfshihet edhe detyrimi i kërkuesit).

Me shkresën nr.313 prot., datë 12.9.2007 Zyra Përbarimore Dibër i është drejtuar debitorit për ekzekutimin e detyrueshëm të detyrimit.

Me shkresën nr.421/1 prot., datë 3.10.2007 Drejtoria e Shërbimit Pyjor Dibër i është drejtuar Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse, në Ministrinë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, me kërkesë për çelje fondesh për shlyerjen e detyrimit.

Me shkresën nr.349 prot., datë 12.10.2007, Zyra Përmbartimore Dibër i është drejtuar Bankës Kombëtare Tregtare dhe Raiffeisen Bank, dega Peshkopi për kërkim të dhënash, lidhur me gjendjen financiare të debitorit në këto banka.

Me shkresën nr.219/1 prot., datë 28.10.2007, Raiffeisen Bank përgjigjet se debitori ka llogari thesari, e cila nuk mund të preket prej tyre pa miratimin e Degës së Thesarit, kurse Banka Kombëtare Tregtare është përgjigjur se debitori nuk ka llogari pranë kësaj banke.

Me vendimin nr.204, datë 28.12.2007, Zyra Përmbartimore Dibër ka vendosur pushimin e urdhrit të ekzekutimit për shkak të mungesës së pasurisë nga ana e debitorit.

4. **Kërkuesi Hasan Buci** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata), me kërkesën e datës 21.9.2011, për konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si pasojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, duke parashtruar, në mënyrë të përmbledhur, sa vijon:

4.1 E drejta për të kërkuar ekzekutimin e vendimit brenda një afati të arsyeshëm është pjesë përbërëse e të drejtës për një proces të rregullt ligjor.

4.2 Mosekzekutimi i vendimit të formës së prerë ka ardhur edhe si pasojë e mosimpenjimit të organit të ngarkuar për këtë qëllim, Zyra Përmbartimore Dibër.

5. **Subjekti i interesuar Drejtoria e Shërbimit Pyjor Dibër**, me shkresën nr.474/1 prot., datë 4.11.2011, parashtron para Gjykatës se, pasi është vënë në dijeni nga Zyra Përmbartimore Dibër për detyrimin për ekzekutimin e vendimit nr.871, datë 11.8.1995 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, ajo ka kërkuar pranë Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave çeljen e fondit për këtë qëllim. Në përfundim të kësaj procedure, nisur nga fakti se përmbartuesi gjyqësor ka vendosur pushimin e ekzekutimit të urdhrit të ekzekutimit, pasi nuk ka gjetur pasuri të debitorit, ky subjekt nuk e ka ndjekur më këtë problem.

6. **Subjekti i interesuar, Zyra Përmbartimore Dibër**, me shkresën nr.1748 prot., datë 11.11.2011, parashtron para Gjykatës se, pasi janë kryer veprimet përkatëse nga përmbartuesi gjyqësor, në vitin 2006 ky ekzekutim u pushua, bazuar në nenin 616 të Kodit të Procedurës Civile (KPC). Me kërkesë të re kërkuesi ka kërkuar riregjistrimin e çështjes përmbartimore. Pas disa veprimeve procedurale, ekzekutimi u pushua përsëri në vitin 2007, pasi deri në fund të vitit nuk u sigurua nga ana e debitorit fondi i nevojshëm. Në vitin 2011, pra pas 5 vitesh, kërkuesi nisi të interesohet përsëri pranë Zyrës Përmbartimore Dibër për këtë çështje dhe pretendon se nuk ka pasur dijeni për vendimin e pushimit të vitit 2007, pasi nuk i është komunikuar. Nëse nuk ka marrë dijeni për vendimin e pushimit kërkuesi ka rrugë të tjera, si rivendosja në afat e të drejtës së ankimit ndaj atij vendimi, apo vënia në ekzekutim duke kërkuar nga gjykata një urdhër ekzekutimi duplikatë. Përfundimisht, kërkuesi nuk i ka shteruar mjetet e nevojshme ligjore për të kërkuar ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë dhe kërkesa e paraqitur në këtë Gjykatë është e parakohshme.

II

A. Lidhur me legjitimitimin e kërkuesit për shkak të mosshterimit të mjeteve ligjore

7. Gjykata vendosi të ndalet fillimisht në pretendimin e përfaqësuesit të subjektit të interesuar, Zyra Përmbartimore Dibër, se kërkuesi nuk i ka shteruar mjetet ligjore për t'iu drejtuar kësaj Gjykate për shkak të mosshtrimit të ankimit kundër vendimit të kësaj zyre për pushimin e ekzekutimit, të vitit 2007.

8. Shterimi i mjeteve juridike nënkupton që kërkuesit duhet të shfrytëzojnë në rrugë normale mjetet juridike, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe efikase për një çështje konkrete. Shterimi i mjeteve të ankimit nënkupton se kërkuesit duhet të përdorin mjetet ligjore, që sipas



sistemit juridik të brendshëm, janë zakonisht në dispozicion të palëve dhe të mjaftueshme për të vënë në vend të drejtat e shkelura (*shih vendimin nr.21, datë 03.6.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata vlerëson se vendimi për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit ka në thelb të tij fillimin e procesit të ekzekutimit dhe vënien në lëvizje të organit kompetent për këtë qëllim. Në këtë aspekt, nuk ka arsye që pas lëshimit të këtij urdhri nga ana e gjykatës, me të cilin kërkuesi ka vënë në lëvizje shërbimin përmbartimor gjyqësor, atij t'i kërkohet kryerja e veprimeve të mëtejshme procedurale (përfshirë edhe ankimin ndaj vendimit të pushimit të ekzekutimit) për të arritur ekzekutimin e një vendimi gjyqësor të formës së prerë, të dhënë në favor të tij.

9. Për sa më sipër Gjykata, nisur nga fakti se kërkuesi nuk ka mjet tjetër ligjor në dispozicion për ekzekutimin e vendimit gjyqësor, konkludon se ai i ka shtuar të gjitha mjetet ligjore për t'iu drejtuar kësaj Gjykate.

III

B. Lidhur me pretendimin për mosekzekutimin, brenda një afati të arsyeshem, të vendimeve gjyqësore të formës së prerë

10. Gjykata ka interpretuar në jurisprudencën e saj parimin e shtetit të së drejtës i cili, si një nga parimet themelore të një shoqërie demokratike, përmban në vetvete edhe detyrimin e autoriteteve publike për të vënë në ekzekutim vendimet gjyqësore të formës së prerë. Zbatimi i plotë dhe efektiv i vendimeve gjyqësore është me rëndësi thelbësore për shtetin, me qëllim që të krijojë, forcojë dhe zhvillojë një sistem gjyqësor të respektueshem nga të gjithë (*shih vendimin nr.43, datë 19.12.2007 të Gjykatës Kushtetuese*). Asnjë organ shtetëror nuk mund të vërë në diskutim drejtësinë e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, por detyrohet të marrë të gjitha masat përkatëse për zbatimin e tyre (*shih vendimet nr.6, datë 31.3.2006; nr.1, datë 19.1.2009; nr.6, datë 06.3.2009; nr.9, datë 1.5.2009; nr.8, datë 23.3.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Gjykata ka theksuar, gjithashtu, se ekzekutimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë përbën një element të rëndësishëm të së drejtës për proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të Konventës europiane për të drejtat e njeriut (KEDNJ). Në opinionin e Gjykatës, gjykimi nuk duhet konceptuar ngushtë, vetëm me sigurimin e një vendimi gjyqësor, por me përfundimin e gjithë këtij procesi, sepse një e drejtë e fituar mbetet pa asnjë vlerë nëse nuk realizohet nëpërmjet ekzekutimit të vendimit (*shih vendimin nr.6, datë 31.3.2006 të Gjykatës Kushtetuese*). Ekzekutimi i vendimit të formës së prerë të gjykatës konsiderohet si faza përfundimtare e realizimit të një të drejte të fituar gjyqësisht. Vetëm pas realizimit të kësaj faze mund të konsiderohet se individit e ka vendosur plotësisht në vend të drejtën e tij të fituar. Në këtë fazë duhet të marrin pjesë aktivisht jo vetëm palët, pra debitori dhe kreditori, por edhe organet kompetente të ngarkuara me ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë. Roli i këtyre organeve bëhet vendimtar, kur debitori refuzon të ekzekutojë vullnetarisht detyrimin e tij karshi kreditorit. Në raste të tilla mund të thuhet se procesi i vendosjes në vend të një të drejte të shkelur përfshin jo vetëm vendimmarrjen e gjykatave për rastin konkret, por edhe veprimet konkrete të organeve përgjegjëse të ngarkuara me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë (*shih vendimin nr.49, datë 21.11.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Gjykata, mbështetur në jurisprudencën e Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), ka theksuar se kohëzgjatja e arsyeshme e procedimeve duhet të vlerësohet nën dritën e rrethanave të çështjes dhe duke marrë në konsideratë kompleksitetin e saj, sjelljen e kërkuesit dhe sjelljen e autoriteteve publike. Për vlerësimin e kompleksitetit të procedimeve duhet të kenë rëndësi të gjitha aspektet e çështjes, përfshi objektin e çështjes, faktet e kundërshtuara, volumin e provave shkresore. Për sa më sipër Gjykata, me qëllim të vlerësimit të afatit kohor të arsyeshem, vlerëson të ndalet në veprimet konkrete të kreditorit, debitorit dhe të Zyrës Përmbartimore.

i) Periudha që duhet marrë në konsideratë

13. Lidhur me periudhën që duhet marrë në konsideratë, Gjykata konstaton se vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër ka marrë formë të prerë në datën 24.8.1995. Në këtë vit kërkuesi i është drejtuar për herë të parë Zyrës Përmbartimore Dibër, e cila në vitin 2004, pas 9 vitesh, ka vendosur pushimin e ekzekutimit të vendimit. Në vitin 2006 kërkuesi i është drejtuar gjykatës për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit. Pas lëshimit të këtij urdhri, kërkuesi i është drejtuar disa herë me kërkesë Zyrës Përmbartimore Dibër, pasi kjo zyrë, vazhdimisht, ka pushuar ekzekutimin e vendimit gjyqësor me arsyetimin se nuk ka gjetur pasuri në llogarinë e debitorit. Siç rezulton edhe nga parashtrimet e subjekteve të interesuara, vendimi gjyqësor nuk është ekzekutuar ende, pas gati 16 vitesh, dhe në këto kushte kjo periudhë konsiderohet tej çdo afati të arsyeshëm.

ii) Kompleksiteti i çështjes

14. Lidhur me kompleksitetin e çështjes, nuk rezulton që çështja të jetë komplekse as nga pikëpamja e fakteve dhe as nga pikëpamja e ligjit, gjë që mund të justifikonte vonesat apo sjelljen mosvepruese të organeve të ngarkuara me këtë qëllim nga ligji.

iii) Sjellja e kërkuesit

15. Gjykata, bazuar në jurisprudencën e GJEDNJ-së, ka theksuar se në lidhje me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore që vendosin detyrime monetare ndaj një shteti, shteti nuk duhet t'i kërkojë personit ndaj të cilit është debitor, të iniciojë procedura të ekzekutimit të vendimit, me qëllim kompensimin e shumës së caktuar. Në raste të tilla autoriteti përkatës shtetëror duhet të njoftohet në mënyrën e duhur për vendimin dhe pra është në pozicionin të marrë të gjitha iniciativat për ta përmbushur atë ose t'ia transmetojë një autoriteti tjetër shtetëror që është kompetent për ekzekutimin (*shih vendimin nr.8, datë 23.03.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Lidhur me sjelljen e kërkuesit, Gjykata vëren se, bazuar në nenin 511 të KPC-së, titulli ekzekutiv vihet në ekzekutim me kërkesë të kreditorit. Për këtë qëllim lëshohet urdhri i ekzekutimit, brenda 5 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës së kreditorit. Neni 515 i KPC-së parashikon se urdhri i ekzekutimit vihet në ekzekutim nga shërbimi përmbartimor gjyqësor, me anë të përmbartuesit gjyqësor, në bazë të kërkesës së kreditorit. Nga aktet e dosjes përmbartimore, rezulton se kërkuesi, pasi ka pritur ekzekutimin vullnetar të këtij vendimi, nga ana e debitorit, i është drejtuar gjykatës për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit dhe më pas i është drejtuar, disa herë radhazi, Zyrës Përmbartimore Dibër me kërkesë për ekzekutimin e vendimit të formës së prerë të dhënë në favor të tij. Lidhur me sjelljen (veprimet) e kërkuesit, Gjykata konstaton se ai ka vepruar në përputhje me të drejtat e tij procedurale, duke shteruar mjetet ligjore në dispozicion të tij për rivendosjen e të drejtës së cenuar. Ndryshe nga sa pretendon subjekti i interesuar Zyra Përmbartimore Dibër, mosushtrimi i ankimit nga ana e kërkuesit, i cili është pajisur me një vendim të ekzekutueshëm kundër shtetit në favorin e tij, ndaj vendimit të përmbartuesit gjyqësor për pushimin e ekzekutimit (vendimi i vitit 2007), nuk mund t'i ngarkohet atij apo ta bëjë përgjegjës për të justifikuar vonesat në ekzekutim nga ana e autoriteteve shtetërore.

iv) Sjellja e autoriteteve publike

17. Lidhur me sjelljen e autoriteteve publike, Gjykata vëren se në këtë drejtim duhet të shqyrtohet sjellja e secilit autoritet të përfshirë në këtë proces. Gjykata ka theksuar se shteti duhet të marrë përsipër vazhdimisht detyrimin për të siguruar palët pjesëmarrëse në proces se do të kenë mundësi reale të ekzekutojnë vendimin gjyqësor të formës së prerë dhe se e drejta për të pasur akses në gjykatë do të ishte iluzion, nëse sistemi ligjor ose zbatimi i tij në praktikë do të bëhej shkak që një vendim gjyqësor i formës së prerë të mbetej inefektiv dhe i pazbatueshëm për një kohë tepër të gjatë (*shih vendimin nr.43, datë 19.12.2007 të Gjykatës Kushtetuese*). Nëse duhet të mbrohen efektivisht të drejtat dhe të respektohet shteti i së drejtës, autoritetet administrative janë të detyruara rrjedhimisht të ekzekutojnë vendimet e formës së prerë. Kur autoritetet administrative refuzojnë, neglizhojnë ose vonojnë t'i ekzekutojnë këto vendime, garancitë, që gëzon një palë e përfshirë në një proces gjyqësor, e humbasin qëllimin e tyre (*shih vendimin nr.8, datë 23.03.2011 të Gjykatës*



Kushtetuese). Gjykata ka theksuar se kërkesit nuk duhet t'i mohohet e drejta për të përfutuar nga ekzekutimi i vendimit gjyqësor thjesht duke u mbështetur në argumentin e pamundësisë financiare të shtetit. Në këtë drejtim, në rastet kur debitor është vetë shteti, autoritetet shtetërore nuk mund të përmendin mungesën e fondeve si justifikim për të mos respektuar një detyrim financiar që vjen nga një vendim gjyqësor. Një vonesë në ekzekutimin e një vendimi mund të justifikohet në rrethana të veçanta, por vonesa nuk mund të jetë në atë shkallë sa të dëmtojë thelbin e së drejtës (*shih vendimet nr.6, datë 6.3.2009; nr.43, datë 19.12.2007; nr.8, datë 23.03.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Gjykata vëren se nga ana e debitorit, Drejtoria e Shërbimit Pyjor Dibër, është nxjerrë si justifikim për mosekzekutimin e detyrimit pikërisht mungesa e fondeve. Nga materialet e dosjes përmbartimore rezulton se ky subjekt i është drejtuar organit epror me kërkesë për çeljen e fondeve vetëm në vitin 2007 dhe me marrjen dijeni të vendimit të pushimit të ekzekutimit, të po atij viti, nuk është interesuar më për këtë çështje dhe nuk ka marrë më asnjë masë për të siguruar fonde me qëllim ekzekutimin e detyrimit. Pushimi i ekzekutimit nga ana e Zyrës Përmbartimore nuk e shkarkon Drejtorinë e Shërbimit Pyjor Dibër, si debitor, nga përmbushja e detyrimit sipas parashikimit ligjor. Ky subjekt nuk rezulton të ketë kryer asnjë veprim që mund të interpretohet si shfaqje e vullnetit të tij për të plotësuar detyrimin që ka ndaj kreditorit Hasan Buci.

19. Për sa i përket sjelljes së Zyrës Përmbartimore Dibër, rezulton se për periudhën 1995-2004 ajo ka qenë pasive, nuk ka kryer asnjë veprim për ekzekutimin e vendimit dhe pas një periudhe 9-vjeçare ka marrë vendim për pushimin e ekzekutimit. Pas lëshimit të urdhrin të ekzekutimit dhe kërkesës së kreditorit drejtuar këtij subjekti (viti 2006 e në vijim), kjo zyrë rezulton të ketë kryer disa veprime procedurale. Fillimisht, ajo ka kërkuar ekzekutimin vullnetar dhe më pas ka urdhëruar ekzekutimin e detyrueshëm të vendimit të gjykatës. Në përfundim të kësaj procedure, bazuar në nenin 616 të KPC-së, ajo ka vendosur pushimin e ekzekutimit për mungesë të pasurisë së debitorit. Në vitin 2007 kërkesi i është drejtuar përsëri me kërkesë Zyrës Përmbartimore, e cila, në përfundim të procedurës, ka vendosur sërish pushimin e ekzekutimit për mungesë të pasurisë së debitorit.

20. Gjykata rithekson se përmbartuesi gjyqësor, si subjekt procedural në fushën e ekzekutimit, është i pajisur me të gjitha mjetet procedurale që mundësojnë ekzekutimin e titullit ekzekutiv. Përballë detyrimit për zbatim të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, të gjitha subjektet, qofshin këto private apo publike, duhet të përgjigjen njëjloj (*shih vendimin nr.21, datë 3.6.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Bazuar në nenin 589 të KPC-së ekzekutimi i detyrimeve në të holla ndaj institucioneve buxhetore bëhet vetëm në llogarinë e tyre përkatëse bankare, në kredi që ata kanë të tretët dhe kur nuk ka të tilla në llogari të thesarit. Kur institucioni buxhetor nuk ka gjendje në llogarinë bankare, as kredi të tretët dhe as në thesar, i kërkohet organit epror financiar përkatës të caktojë fondin e nevojshëm në kapitullin e buxhetit të subjektit nga do të shlyhet detyrimi ose financim të veçantë nga Buxheti i Shtetit. Në këtë kontekst, Gjykata vëren se veprimet e Zyrës Përmbartimore kanë qenë formale dhe ajo nuk ka shfrytëzuar të gjitha mjetet ligjore në dispozicion. Po ashtu, vendimet e përmbartuesit gjyqësor për pushimin e ekzekutimit, të marra në zbatim të nenit 616/d të KPC-së (në fuqi në atë kohë) kanë qenë haptazi të pabazuara, për shkak të zbatimit të gabuar të kësaj norme. Gjykata vlerëson se kjo dispozitë nuk gjen zbatim në rastet kur debitor është shteti. Zyra Përmbartimore duhej të zbatonte nenin 589 të KPC-së, që i referohet specifikisht ekzekutimit të detyrimeve në të holla të institucioneve buxhetore, e cila i njeh të drejtën këtij subjekti të ndërhyjë deri në llogaritë në thesar të debitorit si dhe, kur është rasti, t'i kërkojë vetë organit epror çeljen e fondeve me qëllim ekzekutimin e detyrimeve. Po ashtu Zyra Përmbartimore mund të aplikonte edhe sanksione ndaj personave përgjegjës për mosekzekutimin, mjet ligjor që rezulton të mos jetë përdorur nga ky subjekt. Në këto kushte, Gjykata vlerëson se Zyra Përmbartimore Dibër nuk ka kryer të gjitha veprimet e njohura nga ligji për të siguruar zbatimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, brenda një afati të arsyeshëm.

Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se organet shtetërore, nëpërmjet sjelljes së tyre, kanë cenuar të drejtën e kërkesit për një proces të rregullt ligjor, të sanksionuar në nenin 42 të Kushtetutës dhe në nenin 6 të KEDNJ-së, për shkak të mosekzekutimit të vendimit gjyqësor brenda një afati të arsyeshëm.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131, shkronja “f” dhe nenit 134, pika 1, shkronja “g” të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 dhe vijues të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

VENDOSI:

- Pranimin e kërkesës, duke konstatuar cenimin e së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, si rrjedhojë e moszbatimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr.871, datë 11.8.1995, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Petrit Ploçi, Vladimir Kristo, Admir Thanza, Sokol Berberi, Vitore Tusha, Fatmir Hoxha, Altina Xhoxhaj

VENDIM

Nr.16, datë 27.3.2012

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	Kryetar	i	Gjykatës	Kushtetuese
Vladimir Kristo	Anëtar	i	“	“
Xhezair Zaganjori	Anëtar	i	“	“
Petrit Ploçi	Anëtar	i	“	“
Vitore Tusha	Anëtare	e	“	“
Sokol Berberi	Anëtar	i	“	“
Fatmir Hoxha	Anëtar	i	“	“
Altina Xhoxhaj	Anëtare	e	“	“
Admir Thanza	Anëtar	i	“	“

me sekretare Enina Mullaj, në datën 17.10.2011, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore, me dyer të hapura, çështjen nr. 39/15 Akti, që i përket:

KËRKUES: Eliano Canko, i përfaqësuar nga avokat Thimio Kondi, me deklaram në seancë.

SUBJEKT I INTERESUAR: Prokuroria e Përgjithshme, në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi, si i papajtueshëm me Kushtetutën, i vendimit nr. 41, datë 9.7.2010 të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda dhe i vendimit nr. 1068, datë 21.12.2010 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë (Dhomë Këshillimi).

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/f, 134/1/g të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNJ); neni 27 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.



GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatorin e çështjes, Admir Thanza, përfaqësuesin e kërkuetit që u shpreh për pranimin e kërkesës dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, me vendimin nr. 50 datë 29.7.2008, ndër të tjera, ka vendosur deklarinim fajtor të kërkuetit për veprat penale të “falsifikimit të dokumenteve” të kryer më shumë se një herë e në bashkëpunim në formën e grupit të strukturuar kriminal; të “falsifikimit të letërnjoftimeve, pasaportave apo vizave”, të kryer më shumë se një herë e në bashkëpunim në formën e grupit të strukturuar kriminal; të “falsifikimit të vulave stampave dhe formularëve” të kryer më shumë se një herë e në bashkëpunim në formën e grupit të strukturuar kriminal; të “dhënies ndihmë të kalimit të paligjshëm të kufirit” të kryer më shumë se një herë e në bashkëpunim në formën e grupit të strukturuar kriminal, dhe të “grupit të strukturuar kriminal”, vepra këto të parashikuara nga nenet 186/2, 189/2, 190/2, 298/3/5, 334/1 dhe 333/a/2 të Kodit Penal (KP) dhe përfundimisht në zbatim edhe të nenit 55 të Kodit Penal e ka dënuar me 10 vjet burgim dhe 800 000 lekë gjobë.

2. Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda, bazuar në nenin 375 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), ka çmuar të ndryshojë cilësimin juridik të veprës penale dhe me vendimin nr. 41, datë 9.7.2010, ndër të tjera, ka vendosur deklarinim fajtor të kërkuetit për veprën penale të “shpërdorimit të detyrës” të kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 248 dhe 25 të KP-së duke dënuar kërkuetin me 4 vjet e 6 muaj burgim dhe 400 000 lekë gjobë, si dhe prishjen e vendimit dhe pushimin e çështjes për veprat penale të “grupit të strukturuar kriminal”; të “falsifikimit të dokumenteve” të kryer më shumë se një herë e në bashkëpunim në formën e grupit të strukturuar kriminal; të “falsifikimit të letërnjoftimeve, pasaportave apo vizave” të kryer më shumë se një herë e në bashkëpunim në formën e grupit të strukturuar kriminal; të “falsifikimit të vulave apo stampave e formularëve” të kryer më shumë se një herë e në bashkëpunim në formën e grupit të strukturuar kriminal; të “kalimit të paligjshëm të kufirit” të kryer më shumë se një herë e në bashkëpunim në formën e grupit të strukturuar kriminal.

3. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në Dhomën e Këshillimit, me vendimin nr. 1068, datë 21.12.2010, ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkueti ndaj vendimit nr.41 datë 9.7.2010 të Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda, pasi nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 432 të KPP-së.

II

Pretendimet parashtruar Gjykatës Kushtetuese

4. Me kërkesën në shqyrtim, kërkueti i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (në vijim “Gjykata”) duke pretenduar shfuqizimin e vendimit nr. 41, datë 9.7.2010 të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda dhe të vendimit nr. 1068, datë 21.12.2010, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, në Dhomë Këshillimi, pasi këto vendime i kanë cenuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor në drejtimit e mëposhtme:

4.1. Gjykata e Apelit për Krime të Rënda nuk ka respektuar nenin 142/1 të Kushtetutës që sanksionon detyrimin e arsytimit të vendimit, pasi vendimi i kësaj gjykate nuk është arsytuar në mënyrë të përshtatshme, është kontradiktor dhe alogjik.

4.2. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, duke vendosur mospranimin e rekursit për mungesë të shkaqeve, ka cenuar të drejtën e kërkuarit për t’iu drejtuar gjykatës, parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës, të drejtën e ankimit, të parashikuar nga neni 43 i Kushtetutës, si dhe të drejtën për të pasur kohën dhe lehtësitë e nevojshme për të përgatitur mbrojtjen e tij, të parashikuar nga neni 31/b i Kushtetutës dhe neni 6/3 i KEDNJ-së. Kjo, pasi kërkuari dhe mbrojtësi i tij nuk kanë pasur mundësinë të paraqitin një recurs të “plotë” për shkak se vendimi i Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda nuk është shpallur i arsyetuar në seancë gjyqësore si dhe për shkak të vonesës së zbardhjes së këtij vendimi.

4.3. Gjykata e Apelit për Krime të Rënda ka gjykuar dhe ka dhënë dënim penal për një vepër që nuk është në kompetencën e saj, duke cenuar kështu të drejtën për t’u gjykuar nga një “gjykatë e caktuar me ligj”.

4.4. Gjykata e Apelit për Krime të Rënda nuk ka respektuar parimin e barazisë së armëve dhe të paanshmërisë në gjykim, sepse në vendimin e saj nuk ka argumentuar pse provat dhe pretendimet që e fajësojnë të pandehurin janë të plota dhe të sakta, ndërsa provat që e shfajësojnë janë të papranueshme.

4.5. Gjykata e Apelit për Krime të Rënda ka gabuar sepse, pas ndryshimit të cilësimit juridik të veprës penale-të bërë kur gjykata ishte tërhequr për të marrë vendimin-nuk është riçelur hetimi gjyqësor, duke i mohuar kështu të pandehurit të drejtën për t’u mbrojtur ndaj formulimit të ri të veprës penale.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për pretendimin e mosarsyetimit të vendimeve gjyqësore

5. Lidhur me pretendimin për mënyrën e arsyetimit të vendimit të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda, kërkuari ka parashtruar se vendimi i kësaj gjykate nuk është arsyetuar në mënyrë të përshtatshme, është kontradiktor dhe alogjik për shkak se në këtë vendim: a) nuk përmendet asnjë provë me fuqi të plotë provuese e bindëse që të provojë fakte me vlerë juridike për akuzën e shpërdorimit të detyrës; b) nuk analizohen elementët objektivë dhe subjektivë të veprës penale të shpërdorimit të detyrës; c) nuk arsyetohet për caktimin e llojit të masës së dënimit dhe për individualizimin e dënimit.

6. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar domosdoshmërinë e arsyetimit të vendimit gjyqësor si një garanci për procesin e rregullt ligjor. Vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Gjyqtari duhet të shpjegojë arsyet e vendimeve të tij, duke iu referuar fakteve për të cilat është zhvilluar procesi, ligjeve të zbatueshme dhe kërkesave të ndryshme të palëve (*shih vendimet nr. 11, datë 2.4.2008; nr. 7, datë 9.3.2009; nr. 23, datë 23.7.2009; nr. 38, datë 30.12.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

7. Në rastin konkret, Gjykata konstaton se Gjykata e Apelit për Krime të Rënda, në lidhje me kërkuarin, bazuar në nenin 375 të KPP-së, ka çmuar të ndryshojë cilësimin juridik të veprës penale duke analizuar se veprimet e të pandehurit nga ana objektive nuk përmbajnë elementët e veprës penale të ndihmës për kalim të paligjshëm të kufijve, të parashikuar nga neni 298 i KP-së, vepër për të cilën kërkuari është dënuar nga gjykata e shkallës së parë, por ato të veprës penale të shpërdorimit të detyrës të parashikuar nga neni 248 i KP-së. Por, duke bërë këtë formulim të ri të veprës penale, gjykata e apelit nuk ka analizuar elementët objektivë dhe subjektivë të veprës së shpërdorimit të detyrës, për të cilën ka dënuar kërkuarin dhe nuk ka argumentuar provat mbi të cilat mbështetet ky konkluzion i saj. Në këtë këndvështrim, i vetmi “arsyetim” që përdor gjykata e apelit për akuzën e re të shpërdorimit të detyrës, është analogjia, pra fakti se “*për të njëjtët persona të cilët*



kanë qenë të ngarkuar me detyra shtetërore si punonjës policie në pikën e kalimit kufitar Rinas, të pandehur në të njëjtin procedim, por të proceduar veçmas ... është konkluduar me vendim përfundimtar si akuzë ndaj tyre ajo e shpërdorimit të detyrës” (shih faqen 32 të vendimit nr. 41, datë 9.7.2010 të Gjykatës së Apelit Tiranë).

8. Bazuar në standardet e mësipërme kushtetuese dhe në rrethanat e çështjes, Gjykata vlerëson se vendimi i kundërshtuar nuk është logjik, nuk pasqyron mënyrën mbi bazën e të cilës janë analizuar dhe vlerësuar provat që kundërshtojnë njëra-tjetrën dhe se argumentet e Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda, të përdorura në pjesën arsyetuese, nuk plotësojnë kriteret e arsyetimit për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese të vendimit të kësaj gjykate. Për më tepër, arsyetimi me analogji, lidhur me një çështje tjetër penale, cenon parimin se përgjegjësia penale është individuale. Në këto kushte, Gjykata çmon se vendimi i Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda nuk ka respektuar kërkesat që lidhen me arsyetimin e vendimit gjyqësor dhe për pasojë pretendimi i kërkuarit në këtë aspekt është i bazuar.

B. Për pretendimin e cenimit të së drejtës së aksesit në gjykatë

9. Kërkuari ka parashtruar se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë duke vendosur mospranimin e rekursit për mungesë të shkaqeve, ka cenuar të drejtën e kërkuarit për t’iu drejtuar gjykatës, parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës, si dhe të drejtën e ankimit, parashikuar nga neni 43 i Kushtetutës, sepse ai dhe mbrojtësi i tij nuk kanë pasur mundësinë të paraqitin një recurs të “plotë” për shkak se vendimi i Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda nuk është shpallur i arsyetuar në seancë gjyqësore si dhe për shkak të vonesës së zbardhjes së vendimit. Në këtë mënyrë, atij i është shkëlur gjithashtu edhe e drejta për të pasur kohën dhe lehtësitë e nevojshme për të përgatitur mbrojtjen e tij, parashikuar nga neni 31/b i Kushtetutës dhe neni 6/3 i KEDNJ-së.

10. Gjykata, në jurisprudencën e saj, ka vlerësuar se “Administrimi i mirë i drejtësisë fillon me garancinë që një individ të ketë akses në gjykatë për t’i siguruar atij të gjitha aspektet e një forme gjyqësore të shqyrtimit të çështjes. Aksesit në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal. E drejta për t’iu drejtuar gjykatës është një nga aspektet e të drejtës për gjykim, e sanksionuar në nenin 42 të Kushtetutës. Mohimi i së drejtës për t’iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare prej saj për pretendimet e ngritura, përbën cenim të së drejtës themelore për një proces të rregullt ligjor (shih vendimet nr. 7 datë 11.3.2008; nr.14 datë 3.6.2009 dhe nr.4, datë 23.2.2011 të Gjykatës Kushtetuese). Neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së sanksionojnë në vetvete jo vetëm të drejtën e individit për t’iu drejtuar gjykatës, por edhe detyrimin e shtetit që t’ia garantojë atij këtë akses (shih vendimet nr. 5 datë 6.3.2009 dhe nr. 17, datë 19.6.2009 të Gjykatës Kushtetuese). E drejta e aksesit në gjykatë mund t’i nënshtrohet kufizimeve deri në atë masë sa ato të mos cenojnë thelbin e kësaj të drejte. Në rast se mohohet një e drejtë e tillë, procesi konsiderohet i parregullt, sepse aksesit në gjykatë është, para së gjithash një kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera. Shteti i të drejtës nuk mund të konceptohet pa u njohur individëve të drejtën dhe mundësinë për t’iu drejtuar gjykatës (shih vendimet nr. 18, datë 8.7.2009 dhe nr.4, datë 23.2.2011 të Gjykatës Kushtetuese).

11. Gjykata ka theksuar gjithashtu se personi që ushtron ankim/recurs është i interesuar të ndjekë fatin e ankimit të tij, por kjo nuk nënkupton se i takon vetëm atij përgjegjësia të ndjekë pafundësisht fatin e dosjes gjyqësore, e cila administrohet nga gjykata dhe jo nga kërkuari (shih vendimet nr.4, datë 10.2.2005; nr.22, datë 26.7.2006; nr.38, datë 30.12.2010 të Gjykatës Kushtetuese). Për këtë arsye, Gjykata ka përcaktuar se i takon dhe administratës gjyqësore të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm të njoftojë në kohë kërkuarin jo vetëm për përmbajtjen e vendimit gjyqësor por edhe për plotësimin e kërkesave të ushtrimit të rekursit, duke qenë se ajo administron dhe dosjen gjyqësore me vendimin ndaj të cilit ushtrohet recursi (shih vendimin nr.32, datë 22.07.2011 të Gjykatës Kushtetuese). Në këtë këndvështrim, ajo ka çmuar se e drejta e ankimit,

ashtu si edhe ajo e aksesit në gjykatë, nuk mund t'i cenohen kërkuesit për shkaqe që rrjedhin nga mangësitë ose gabimet në veprimtarinë e vetë organeve shtetërore (*shih vendimet nr.22, 26.7.2006; nr.5, datë 2.3.2011 dhe nr.32, datë 22.7.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Nga materialet e dosjes gjyqësore rezulton se në seancën e datës 9.7.2010, Gjykata e Apelit për Krime të Rënda ka lexuar dispozitivin e vendimit, por nuk rezulton se kur është zbardhur vendimi (i arsyetuar) nr. 41, datë 9.7.2010 i kësaj Gjykate. Ndërkohë, në datë 9.8.2010 mbrojtësi i kërkuesit ka paraqitur rekurs për zënien e afatit dhe, meqë deri në atë datë nuk ishte zbardhur akoma arsyetimi i vendimit de quo, ka rezervuar të drejtën e paraqitjes së shkaqeve të plota të ankimit në një moment të dytë. Rekursi i plotë nuk është paraqitur nga kërkuesi. Po ashtu nga materialet e dosjes gjyqësore rezulton se Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda ka i dërguar dosjen gjyqësore Gjykatës së Lartë në datë 29.10.2010. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në Dhomë Këshillimi, me vendim nr. 1068, datë 21.12.2010, ka vendosur mospranimin e rekursit, pasi nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 432 të KPP-së, pavarësisht se këto shkaqe nuk u paraqitën nga kërkuesi.

13. Në rastin objekt shqyrtimi, duke qenë se nga materialet e dosjes gjyqësore nuk rezulton asnjë shkresë ose dokument tjetër që kërkuesi të jetë njoftuar nga administrata gjyqësore për mungesat në paraqitjen e rekursit, të cilat, në fund të fundit, nuk vareshin prej tij por prej administratës gjyqësore, Gjykata rithekson qëndrimin e saj se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, para se të vendosë mospranimin e rekursit, duhet të verifikojë nëse sekretaria gjyqësore ka zbatuar detyrimin ligjor për vënien në dijeni të të pandehurit, për të plotësuar rekursin. Të njëjtin detyrim kanë përcaktuar Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në vendimin unifikues nr. 5, datë 15.9.2009, sipas kuptimit që ato i kanë dhënë nenit 415/2 të KPP-së, në rastin kur rekursi është depozituar pa nënshkrimin e mbrojtësit. Këto kërkesa ligjore kanë rëndësi kushtetuese, sepse garantojnë realisht të drejtën e individit për t'iu drejtuar Gjykatës së Lartë (*shih vendimet nr. 38, datë 30.12.2010 dhe nr.26, datë 13.6.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Për këtë arsye, Gjykata çmon se i dilte si detyrë Kolegjit Seleksionues të Gjykatës së Lartë të verifikonte se përse nuk ishin paraqitur shkaqet nga ana e kërkuesit, sidomos kur provohet shkresërisht se ai kishte paraqitur rekurs për zënien e afatit. Nëse arsyet për mosparaqitjen e shkaqeve të rekursit kishin të bënin me veprimet ose mosveprimet e administratës gjyqësore, atëherë Kolegji duhet të njoftonte kërkuesin duke i lënë kohën e nevojshme për të plotësuar dokumentacionin. Nëse kërkuesi nuk i kishte paraqitur shkaqet për faj të tij, atëherë Kolegji Seleksionues ishte në kushtet për të mos pranuar rekursin për shqyrtim. Veprimet ose mosveprimet e parregullta të administratës gjyqësore nuk duhet t'i ngarkohen individit, i cili nuk mund të jetë përgjegjës për mbarëvajtjen e punës së saj (administratës).

15. Për më tepër, Gjykata çmon se duke qenë se edhe vetë vendimi i gjykatës së apelit, siç u argumentua më lart, nuk ka përmbushur kriteret që lidhen me standardin e arsyetimit të vendimeve gjyqësore, kërkuesi ishte në pamundësi të paraqiste shkaqet e plota të ankimit ndaj këtij vendimi. Për rrjedhojë, në këtë drejtim, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka zhvilluar një proces të parregullt në kuptimin kushtetues.

C. Për pretendimin e cenimit të së drejtës për t'u gjykuar nga një "gjykatë e caktuar me ligj"

16. Lidhur me pretendimin e cenimit të së drejtës për t'u gjykuar nga një "gjykatë e caktuar me ligj", kërkuesi parashtron se Gjykata e Apelit për Krime të Rënda ka gjykuar dhe ka dhënë dënim penal për një vepër që nuk është në kompetencën e saj.

17. Gjykata, në këtë drejtim, ka theksuar se shqyrtimi i çështjes nga një "gjykatë e caktuar me ligj" është një element i procesit të rregullt ligjor, sipas nenit 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 6 të KEDNJ-së. Termi "gjykatë" karakterizohet në sensin material nga funksioni i saj gjyqësor që ka të bëjë me zgjidhjen e çështjeve që janë në kompetencë të saj, në një



proces të zhvilluar mbi një procedurë ligjërish të përcaktuar dhe në pajtim me shtetin e së drejtës. E drejta e çdo pale për t'u dëgjuar në seancë përpara një gjykate kompetente, kërkon që gjykata të ketë juridiksion për të dëgjuar çështjen dhe që kompetenca t'i jetë dhënë asaj prej ligjit (*shih vendimet nr.23, datë 23.07.2009, nr.7, datë 9.3.2009 dhe nr.31, datë 01.12.2005 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Nga materialet e çështjes rezulton se kërkuesi Eliano Canko është akuzuar dhe dënuar nga Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda për disa vepra penale ("falsifikimit të dokumenteve" të kryer më shumë se një herë e në bashkëpunim në formën e grupit të strukturuar kriminal; të "falsifikimit të letërnjoftimeve, pasaportave apo vizave", të kryer më shumë se një herë e në bashkëpunim në formën e grupit të strukturuar kriminal; të "falsifikimit të vulave stampave dhe formularëve" të kryer më shumë se një herë e në bashkëpunim në formën e grupit të strukturuar kriminal; të "dhënies ndihmë të kalimit të paligjshëm të kufirit" të kryer më shumë se një herë e në bashkëpunim në formën e grupit të strukturuar kriminal, dhe të "grupit të strukturuar kriminal"), të parashikuara nga nenet 186/2, 189/2, 190/2, 298/3/5, 334/1 dhe 333/a/2 të KP-së, disa prej të cilave sipas nenit 75/a të KPP-së janë në kompetencë të gjykatës për krime të rënda.

19. Gjykata e Apelit për Krime të Rënda, bazuar në nenin 375 të KPP-së, duke i dhënë faktit një përcaktim të ndryshëm nga Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, e ka dënuar kërkuesin për një tjetër veprë penale (shpërdorim detyre të kryer në bashkëpunim) të parashikuar nga nenet 248 dhe 25 të KP-së, e cila sipas nenit 75/a të KPP-së nuk hyn në kompetencën e gjykatës për krime të rënda.

20. Sipas nenit 375 të KPP-së: "*me vendim përfundimtar gjykata mund t'i japë faktit një përcaktim të ndryshëm nga ai që ka bërë prokurori ose i dëmtuari akuzues, më të lehtë ose më të rëndë, me kusht që vepra penale të jetë në kompetencën e saj*". Edhe Gjykata Kushtetuese, në vendimin nr.50, datë 30.7.1999 ka përcaktuar se: "*Kur gjykata bën cilësimin e drejtë ligjor të veprës ... (omissis)... ajo ka bërë një zbatim të drejtë të ligjit dhe duke vënë në dijeni palët u krijon atyre mundësinë për t'u ankuar ndaj vendimit. Për zbatimin e nenit 375 të Kodit të Procedurës Penale, kërkohen edhe kushte të tjera. Njëri nga kushtet është që gjykata këtë ndryshim mund ta bëjë kur vepra penale është në kompetencën e saj. Në rast se vepra penale nuk është në kompetencë të gjykatës, ajo nuk mund ta bëjë ndryshimin, por ia dërgon çështjen organit kompetent. ... Zbatimi në këtë mënyrë i kërkesave të nenit 375 të Kodit të Procedurës Penale, është një garanci për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor, duke e vënë gjykatën në rolin që i takon për dhënien e drejtësisë*".

21. Nga ana tjetër, neni 5/2 i ligjit nr. 9110, datë 24.7.2003 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatave për Krime të Rënda" parashikon se: "*Kur gjatë gjykimit ndryshohet cilësimi juridik i veprës penale dhe për këtë shkak kompetente është një gjykatë tjetër, gjykimi vazhdon dhe përfundon në gjykatën e krimeve të rënda, duke zbatuar dispozitat e Kodit të Procedurës Penale*".

22. Për zgjidhjen e këtij konflikti normash juridike, Gjykata vlerëson të arsyeshme t'i referohet kriterëve që tradicionalisht përdorin rendet juridike në këto situata, që konsistojnë në:

- *kriteri i kompetencës*, sipas të cilit mbizotëron norma e vendosur nga burimi i të drejtës të cilës i është atribuar rezerva në disiplinën e fushës brenda të cilës futet rrethana;

- *kriteri i veçantë*, i shprehur nga parimi "*lex specialis derogat generali*", sipas të cilit mbizotëron norma më specifike (e veçantë); pra norma specifike ka përparësi nga norma e përgjithshme. Në raportin ndërmjet kodit të procedurës penale dhe ligjit organik të gjykatave për krime të rënda, ky i fundit sanksionon në mënyrë specifike rregullat e procedimit për këto gjykata dhe si i tillë konsiderohet normë specifike.

23. Bazuar në vlerësimet e mësipërme si dhe në faktin se ligji nr.9276, datë 16.9.2004, që ndryshoi kompetencën lëndore të gjykatave të krimeve të rënda, ka parashikuar shprehimisht kompetencën lëndore të gjykatës për krime të rënda në rastin specifik kur gjatë gjykimit në këtë të fundit ndryshohet cilësimi juridik i veprës penale dhe për veprën e re penale kompetente është një

gjykatë tjetër, Gjykata arrin në përfundimin se gjykata për krime të rënda ka qenë kompetente për të shqyrtuar akuzat e ngritura ndaj kërkuesit. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuesit për cenimin e të drejtës për t'u gjykuar nga një "gjykatë e caktuar me ligj", është i pabazuar.

Ç. Për pretendimin e cenimit të parimit të paanshmërisë në gjykim

24. Kërkuesi ka pretenduar se *gjykata e apelit nuk ka respektuar parimin e paanshmërisë në gjykim dhe atë të barazisë së armëve, sepse në vendimin gjyqësor janë analizuar vetëm provat dhe pretendimet që e fajësojnë të pandehurin, ndërsa provat që e shfajësojnë atë nuk janë analizuar dhe as kundërshtuar*. Ai ka parashtruar gjithashtu se këto shkelje procedurale, edhe pse nuk janë paraqitur në rekurs, duhet t'i shqyrtonte kryesisht edhe Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në Dhomë Këshillimi.

25. Për sa i përket pretendimit mbi cenimin e parimit të paanshmërisë së gjykatave, në kuptim të nenit 42/2 të Kushtetutës, Gjykata, në jurisprudencën e saj, ka theksuar se ekzistojnë dy teste për të vlerësuar nëse një gjykatë është e paanshme: ai *subjektiv*, i cili lidhet ngushtë me bindjen e brendshme që krijon gjyqtari për zgjidhjen e çështjes në gjykim, si dhe testi objektiv me të cilin kuptohet dhënia e garancive të nevojshme për gjykim të paanshëm nga vetë gjykata, përmes mënjanimi prej saj të çdo dyshimi të përligjur në këtë drejtim. Në shtetin e së drejtës kërkesa për një gjykim të paanshëm merr rëndësi të veçantë në funksion të besimit në dhënien e drejtësisë, që në shoqëritë demokratike duhet ta krijojnë në çdo rast jo vetëm palët në gjykim, por dhe çdo qytetar i thjeshtë (*shih vendimet nr.12, datë 13.04.2007; nr.21, datë 29.04.2010; nr.7, datë 07.03.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Në çështjen në shqyrtim, kërkuesi ka parashtruar si rrethanë për njëanshmërinë e gjykatës së apelit mënyrën e vlerësimit të provave prej kësaj gjykate. Gjykata, në jurisprudencën e saj të konsoliduar është shprehur se pranimi dhe çmuarja e provave është atribut i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, i cili nuk përbën objekt kontrolli për Gjykatën Kushtetuese (*shih vendimin nr. 23, datë 17.5.2010 të Gjykatës Kushtetuese*). Kjo e fundit mund dhe duhet të investohet kur ndaj një procesi gjyqësor ka pretendime për rrugët dhe mënyrën e marrjes së provave dhe të fiksimit të tyre, por jo për mënyrën e vlerësimit të tyre (*shih vendimet nr.7, date 27.4.2005 dhe nr. 31, datë 5.7.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

27. Duke pasur parasysh sa më sipër, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesit për cenimin e parimit të paanshmërisë në gjykim, bazuar mbi mënyrën e vlerësimit të provave, është haptazi i pabazuar.

28. Po ashtu lidhur me parimin e barazisë së armëve, Gjykata ka vlerësuar se veçanërisht në procesin penal, barazia e armëve, kontradiktoriteti dhe lidhur ngushtë me këto, mbrojtja e të pandehurit, e garantuar shprehimisht në nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së, përbëjnë në vetvete elementët më të qenësishëm e thelbësorë të procesit të rregullt ligjor. Synim kryesor është realizimi i një debati real ndërmjet akuzës dhe mbrojtjes, gjë që ndikon pozitivisht edhe në mënyrë të drejtpërdrejtë në zbulimin e së vërtetës dhe dhënien e drejtësisë nga gjykata, me objektivitet e paanësi (*Shih vendimet nr.19, datë 12.6.2003 dhe nr.19, datë 18.9.2008 të Gjykatës Kushtetuese*). Lidhur me parimin e barazisë së armëve, Gjykata mban qëndrimin se provat paraqiten dhe marrin vlerën e tyre në debatin gjyqësor, ku secila palë ka mundësi për të paraqitur argumentet e veta në një pozitë jo më pak të favorshme se pala tjetër (*Shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.19, datë 18.9.2008 dhe nr.7, datë 27.4.2005*).

29. Në rastin konkret, Gjykata konstaton se në të gjitha shkallët e gjykimit të kërkuesit, mbrojtësit të tij i është dhënë mundësi për të dëgjuar dhe debatuar të gjithë argumentet ligjorë të ngritur nga akuza. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuesit për cenimin e parimit të barazisë së armëve, është i pabazuar.

30. Lidhur me pretendimin e kërkuesit për cenimin e të drejtës së mbrojtjes, përderisa Gjykata ka vlerësuar më lart cenimin e të drejtës së aksesit në gjykatë, nuk e sheh të arsyeshme të



ndalet tek ky pretendim duke çmuar se cenimi i të drejtës së aksesit ka passjellë edhe cenimin e të drejtës së mbrojtjes së kërkuarit.

31. Si përfundim, në vijim të arsytimit të mësipërm, Gjykata vlerëson se në procesin e zhvilluar nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131, shkronja “f” dhe nenit 134, pika 1, shkronja “g” të Kushtetutës, si dhe neneve 72 dhe 77 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”,

VENDOSI:

- Pranimin e kërkesës.
 - Shfuqizimin, si të papajtueshëm me Kushtetutën, të vendimit nr. 41, datë 9.7.2010 të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda, për sa i përket të gjykuarit Eliano Canko, me shumicë votash (*Votuan kundër shfuqizimit të vendimit nr. 41, datë 9.7.2010 të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda, gjyqtarët V. Kristo, Xh. Zaganjori, F. Hoxha*).
 - Shfuqizimin, si të papajtueshëm me Kushtetutën, të vendimit nr. 1068, datë 21.12.2010 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë (Dhomë Këshillimi), për sa i përket të gjykuarit Eliano Canko, njëzëri.
 - Kthimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Xhezair Zaganjori, Vladimir Kristo, Sokol Berberi, Vitore Tusha, Petrit Pllaçi, Fatmir Hoxha, Admir Thanza, Altina Xhoxhaj

VENDIM

Nr.17, datë 27.3.2012

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	Kryetar	i	Gjykatës	Kushtetuese
Vladimir Kristo	Anëtar	i	“	“
Xhezair Zaganjori	Anëtar	i	“	“
Petrit Pllaçi	Anëtar	i	“	“
Sokol Berberi	Anëtar	i	“	“
Fatmir Hoxha	Anëtar	i	“	“
Admir Thanza	Anëtar	i	“	“
Altina Xhoxhaj	Anëtare	e	“	“
Vitore Tusha	Anëtare	e	“	“

me sekretare Enina Mullaj, në datën 22.11.2011, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr. 46/21 Akti që i përket:

KËRKUES: Shoqata e Importuesve dhe Tregtuesve të Gazit të Lëngshëm, përfaqësuar nga avokatët Shpëtim Beqiraj dhe Erind Mërkuri, me autorizim.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Këshilli i Ministrave, i përfaqësuar nga zj. Marsida Xhaferllari, me autorizim.

Ministria e Financave, i përfaqësuar nga zj. Isida Koka dhe z. Renald Rista, me autorizim.

OBJEKTI: - Shfuqizimi, si e papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, të shprehjes .. “ose në sektorët e veçantë të përcaktuar në këtë vendim apo në udhëzimet e Ministrisë së Financave”, të parashikuar në pikat 1 dhe 6.2 të VKM-së nr.96, datë 17.2.2010 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.781, datë 14.11.2007 “Për karakteristikat teknike e funksionale të pajisjeve fiskale, sistemit të integruar të kompjuterizuar për transformimet periodike, automatike, të deklarimeve financiare, sistemit të komunikimit, për procedurën e dokumentacionin për miratimin e tyre dhe për kriteret për pajisjen me autorizim të shoqërive të autorizuara për ofrimin e pajisjeve fiskale”.

- Shfuqizimi, si i papajtueshëm me Kushtetutën, i pikës 12 të udhëzimit nr.16, datë 3.5.2010 të Ministrit të Financave “Për administrimin dhe dokumentimin e procedurave të pajisjeve fiskale”.

Pezullimi i zbatimit të fjalisë “...ose në sektorët e veçantë të përcaktuar në këtë vendim apo në udhëzimet e Ministrisë së Financave...” në pikat 1 dhe 6.2 të VKM-së nr.96, datë 17.2.2010 dhe pezullimi i pikës 12 të udhëzimit nr.16, datë 3.5.2010 të Ministrit të Financave.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 11, 17, 41, 118, 131/c, 134/f dhe 155 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë dhe nenet 45, 49 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatoren e çështjes, Vitore Tusha; përfaqësuesit e kërkuarit, Shoqata e Importuesve dhe Tregtuesve të Gazit të Lëngshëm që kërkuan pranimin e kërkesës; përfaqësuesit e subjekteve të interesuar, Këshilli i Ministrave dhe Ministria e Financave, që kërkuar rrëzimin e saj, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kuvendi i Republikës së Shqipërisë ka miratuar ligjin nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Ligji përcakton, midis të tjerash, kriteret dhe procedurat për vendosjen dhe përdorimin e pajisjeve fiskale dhe kasave, rrethin e subjekteve që duhet të përmbushin këtë detyrim ligjor si dhe kontrollin e sistemit automatik të mbledhjes së të dhënave të pajisjeve fiskale.

2. Këshilli i Ministrave, në zbatim të kërkesave të ligjit të mësipërm, ka miratuar vendimin nr.96, datë 17.2.2010 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.781, datë 14.11.2007 “Për karakteristikat teknike e funksionale të pajisjeve fiskale, sistemit të integruar të kompjuterizuar për transformimet periodike, automatike, të deklarimeve financiare, sistemit të komunikimit, për procedurën e dokumentacionin për miratimin e tyre dhe për kriteret për pajisjen me autorizim të shoqërive të autorizuara për ofrimin e pajisjeve fiskale”” (në vijim vendimi i Këshillit të Ministrave nr.96/2010).

3. Ministri i Financave, në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.96/2010, ka nxjerrë udhëzimin nr.16, datë 03.05.2010 “Për administrimin dhe dokumentimin e procedurave të pajisjeve fiskale”, i cili, në rrethin e subjekteve që kanë detyrimin e vendosjes së kasave fiskale, përfshin, përveç subjekteve që tregtojnë gazin e lëngshëm me pakicë, edhe shoqëritë e tregtimit me shumicë të hidrokarbureve (në vijim udhëzim nr.16/2010).



II

4. Shoqata e Importuesve dhe Tregtuesve të Gazit të Lëngshëm, (*kërkuesi*) i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese, për shfuqizimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.96/2010 dhe udhëzimit nr.16/2010 të Ministrit të Financave duke parashtruar, në mënyrë të përmbledhur, se:

4.1 Është cenuar liria ekonomike, garantuar nga neni 11 i Kushtetutës, në drejtim të pavarësisë nga kontrolli shtetëror dhe të lirisë fiskale mbi të ardhurat, pasi parashikimi i detyrimit për blerjen, instalimin, mirëmbajtjen dhe përditësimin periodik të pajisjeve fiskale edhe për importuesit dhe tregtuesit me shumicë të gazit të lëngshëm rëndon ndjeshëm mbi buxhetin e këtyre shoqërive. Gjithashtu, kufizimi i lirisë ekonomike është bërë pa ligj.

4.2 Në nxjerrjen e akteve nënligjore nuk janë respektuar kërkesat e nenit 118 të Kushtetutës, që detyron nxjerrjen e këtyre akteve në bazë dhe për zbatim të ligjeve nga organet e përcaktuara në Kushtetutë.

4.3 Kufizimi i lirisë ekonomike cenon parimin e sigurisë juridike dhe të drejtën e pronës, në kuptim të neneve 4 dhe 41 të Kushtetutës.

4.4 Zbatimi i akteve nënligjore të mësipërme duhet të pezullohet pasi ato dëmtojnë rëndë interesat e anëtarëve të Shoqatës së Importuesve dhe Tregtuesve të Gazit të Lëngshëm.

5. **Subjektet e interesuara, Këshilli i Ministrave dhe Ministria e Financave**, pretenduan rrëzimin e kërkesës duke prapësuar si më poshtë:

5.1 Kërkuesi nuk legjitimohet për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese për arsye se:

5.1.a Në momentin e hyrjes në fuqi të akteve objekt kundërshtimi, shoqata nuk ishte krijuar dhe regjistruar si person juridik në përputhje me ligjin. Në këtë kuptim, kërkuesi nuk ka interes legjitim të lidhur drejtpërdrejt me çështjen, pasi nuk e ka fituar asnjëherë interesin që pretendon se i është cenuar nga aktet nënligjore.

5.1.b Duhet të ushtronte ankim në gjykatën e juridiksionit të zakonshëm për të kundërshtuar aktet nënligjore si të paligjshme e që cenojnë interesat dhe të drejtat e tij. Por edhe kjo e drejtë ka rënë në dekadencë pasi gjatë afatit 30 ditor, brenda të cilit mund të ushtronte ankimin, ky subjekt nuk ishte krijuar ende si person juridik.

5.2 Pretendimi për kufizimin e lirisë ekonomike është i pabazuar, pasi liria ekonomike nuk nënkupton pavarësi ndaj çdo lloj kontrolli shtetëror. Kufizimi i pretenduar nuk është vendosur nga aktet nënligjore të kundërshtuara, por nga ligji nr.9920, datë 19.5.2008 "Për procedurat tatimore", nëpërmjet sanksionimit të detajuar të procedurës së mbledhjes së tatimit.

5.3 Edhe pretendimi për cenimin e të drejtës së pronës, si rezultat i vendosjes së sistemeve paralele të kontrollit të të ardhurave dhe i zbatimit të detyrimeve tatimore dy herë për të njëjtin transaksion është i pambështetur në nenin 41 të Kushtetutës.

5.4 Kufizimi i vendosur përmes ligjit dhe jo akteve nënligjore plotëson të gjitha standardet kushtetuese, *inter alia*, edhe parimin e proporcionalitetit. Në këtë kuptim, pretendimi i kërkuesit për cenimin e këtij parimi është i pabazuar, pasi në rastin e nxjerrjes së ligjeve për mbledhjen e taksave shteti nuk ka barrën të provojë ekzistencën e përputhshmërisë me interesin e përgjithshëm, sepse një fakt i tillë prezumohet.

5.5 Aktet nënligjore objekt kundërshtimi janë në përputhje me nenin 118/2 të Kushtetutës, pasi kanë dalë në respektim të rezervës ligjore absolute për të mundësuar zbatimin e ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore" që autorizon nxjerrjen e akteve nënligjore. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuesit është i pabazuar.

III

A. Lidhur me legjitimimin e kërkuetit

6. Gjykata Kushtetuese (Gjykata) përpara shqyrtimit të pretendimeve të kërkuetit, vlerëson pretendimet e parashtruara nga subjektet e interesuara lidhur me legjitimimin e kërkuetit në këtë gjykim kushtetues.

7. Subjektet e interesuara, Këshilli i Ministrave dhe Ministria e Financave, kanë pretenduar se kërkueti nuk legjitimohet për të vënë në lëvizje gjykimin kushtetues për arsye se Shoqata e Tregtuesve dhe Importuesve të Gazit të Lëngshëm nuk ishte krijuar si person juridik në momentin e hyrjes në fuqi të akteve nënligjore objekt kundërshtimi.

8. Çështjen e legjitimitit të kërkuetit (locus standi) Gjykata e vlerëson si një ndër aspektet kryesore që lidhen me inicimin e një procesi kushtetues. Në gjykime të kontrollit të kushtetutshmërisë së normës, subjektet iniciuese që parashikohen në nenin 134, pika 2 të Kushtetutës kanë detyrimin për të provuar lidhjen e domosdoshme që duhet të ekzistojë ndërmjet veprimtarisë ligjore që ato kryejnë dhe çështjes kushtetuese të ngritur. Shoqatat, që përfshihen në subjektin kushtetues “organizatat e tjera” janë të specifikuar në nenin 134, pika 1, shkronja “f” të Kushtetutës, si një ndër subjektet që ushtrojnë në mënyrë të kushtëzuar të drejtën për t’iu drejtuar kësaj Gjykate, duke pasur legjitimitet vetëm për ato çështje që lidhen me interesat e tyre. Gjykata ka theksuar se interesi konsiston tek e drejta e shkelur, tek dëmi real apo potencial dhe jo tek premiset teorike mbi antikushtetutshmërinë e normës që ka sjellë këtë cenim të interesit dhe se ky interes duhet të jetë i sigurt, i drejtpërdrejtë dhe vetjak (*shih vendimet nr.31, datë 18.06.2010 , nr.4, datë 23.02.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

9. Gjykata thekson se, në kuptim të nenit 134, pika 1, shkronja “f” të Kushtetutës, që përcakton “organizatat e tjera” si subjekte që legjitimohen të vënë në lëvizje një gjykim kushtetues, momenti i krijimit, si dhe kohëzgjatja e veprimtarisë së tyre, nuk përbëjnë kusht për legjitimimin e këtyre subjekteve.

10. Bazuar në aktet e administruara në këtë gjykim (statut dhe akt themelimi), Gjykata konstaton se kërkueti është një subjekt juridik, me 23 anëtarë themelues, i regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr.3007, datë 10.2.2011. Anëtarë të shoqatës janë shoqëritë e tregtimit me shumicë dhe pakicë të gazit të lëngshëm në Shqipëri. Në këto kushte, Gjykata vlerëson se kërkueti është krijuar si shoqatë dhe gëzon personalitet juridik në përputhje me kërkesat e ligjit. Në këtë kuptim, ndryshe nga sa pretendojnë përfaqësuesit e subjekteve të interesuara, Këshilli i Ministrave dhe Ministria e Drejtësisë, kërkueti legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të rregullimit të parashikuar nga neni 134, shkronja “f” të Kushtetutës dhe nenit 49, pika 2 i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

11. Gjithashtu, Gjykata vlerëson se kërkueti legjitimohet *ratio temporis*, pasi kërkesa është paraqitur brenda afatit 3-vjeçar të përcaktuar në nenin 50 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

12. Për sa i përket legjitimitit *ratione materiae*, Gjykata, bazuar në statutin e kërkuetit konstaton se Shoqata e Importuesve dhe Tregtuesve të Gazit të Lëngshëm është organizatë vullnetare që synon, midis të tjerash, të mbrojë interesat e importuesve dhe tregtuesve të gazit të lëngshëm, për sa i përket burimeve materiale, energjetike, financiare dhe njerëzore të nevojshme. Po ashtu, Gjykata vëren se nenet objekt kundërshtimi përcaktojnë rregulla të ushtrimit të veprimtarisë ekonomike të anëtarëve të shoqatës që përfaqëson kërkueti.

13. Nga sa më sipër, Gjykata vlerëson se ekziston lidhja e drejtpërdrejtë midis misionit për të cilin është krijuar kërkueti dhe pasojave që rrjedhin nga normat, objekt shqyrtimi. Për rrjedhojë, interesi për të vepruar i kërkuetit është i sigurt, i drejtpërdrejtë dhe vetjak dhe, në këto rrethana, ai legjitimohet të vërë në lëvizje këtë gjykim kushtetues.



B. Lidhur me pezullimin e zbatimit të akteve nënligjore

14. Gjykata mori paraprakisht në shqyrtim kërkesën për pezullimin e zbatimit të pikave 1 dhe 6.2 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.96, datë 17.2.2010 dhe pikës 12 të udhëzimit nr.16, datë 3.5.2010 të Ministrit të Financave.

15. Në mbështetje të nenit 45 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, Gjykata i vlerësoi të pabazuara argumentet e parashtruara për cenimin e interesave shtetërorë e shoqërorë ose të individëve nga zbatimi i menjëhershëm i akteve nënligjore dhe, për rrjedhojë, vendosi rrëzimin e kërkesës.

C. Lidhur me pretendimin për cenimin e parimit të lirisë së veprimtarisë ekonomike

16. Kërkuesi pretendon se përfshirja e tyre në kategorinë e tatimpaguesve që kanë detyrimin të vendosin kasa fiskale i ngarkon me detyrimin për blerjen, instalimin dhe përdorimin e sistemit fiskal, që në rastin e shoqërive të hidrokarbureve me shumicë konsiston në pajisjen fiskale dhe njësinë matëse elektronike me litra. Ky detyrim cenon lirinë ekonomike, garantuar nga neni 11 i Kushtetutës, në drejtim të pavarësisë nga kontrolli shtetëror dhe të lirisë fiskale mbi të ardhurat. Për më tepër, kufizimi i lirisë ekonomike është bërë me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.96, datë 17.2.2010 dhe udhëzimin nr.16, datë 3.5.2010 të Ministrit të Financave dhe jo me ligj siç përcakton Kushtetuta.

17. Gjykata, në jurisprudencën e saj, e ka trajtuar lirinë e veprimtarisë ekonomike, të garantuar nga neni 11 i Kushtetutës, si të drejtën për të lidhur kontrata, individualisht ose kolektivisht, lirisht dhe mbi bazën e vullnetit personal, të drejtën për të zgjedhur aktivitetin që dëshiron të ushtrojë individi, të drejtën për të zgjedhur një punë sipas preferencës etj. Kjo liri përfshin të gjitha të drejtat që lidhen me prodhimin, shpërndarjen ose konsumin e mallrave dhe shërbimeve. Forma më e lartë e lirisë ekonomike nënkupton të drejtën e pronës, lirinë pa asnjë kufizim të qarkullimit të fuqisë punëtore, të kapitalit dhe të mallrave; se individi ka të drejtë të punojë, të prodhojë, të konsumojë dhe të investojë në çdo mënyrë që zgjedh dhe kjo liri duhet të mbrohet nga shteti. Po ashtu, liria e veprimtarisë ekonomike përmban në vetvete shumë të drejta dhe liri, si: liria e biznesit ose aftësia për të krijuar dhe mbyllur një sipërmarrje, liria e tregtisë ose mungesa e barrierave lidhur me importimin dhe eksportimin e mallrave dhe shërbimeve, liria monetare si masë për të garantuar qëndrueshmëri të çmimit, liria fiskale mbi të ardhurat qoftë individuale, qoftë ndaj biznesit në mënyrë të veçantë, të drejtat e pronës si aftësi e individëve për të grumbulluar, poseduar dhe disponuar sende të lirë nga ndërhyrja e shtetit, liria e investimit dhe qarkullimit të lirë të kapitaleve, veçanërisht kapitalit të huaj, liria financiare dhe pavarësia nga kontrolli shtetëror, liria e punës për të ndërvepruar pa kufizime nga shteti (*shih vendimin nr.17, datë 25.7.2008 të Gjykatës Kushtetuese*). Krahas kuptimit të mësipërm, liria e veprimtarisë ekonomike nënkupton edhe detyrimin e shtetit që, nëpërmjet legjislationit, të ndërhyjë në rregullimin e kësaj lirie me qëllim që, krahas lirisë së veprimtarisë ekonomike, të garantohet edhe parimi i shtetit social dhe i të mirës së përbashkët. Ky detyrim për rregullim i ligjvënësit shprehet nëpërmjet nxjerrjes së normave konkrete juridike, me anë të të cilave disiplinohet ushtrimi i veprimtarisë së lirë ekonomike në sektorë apo fusha të caktuara me qëllim mbrojtjen e tregut nga deformimet që natyrshëm mund t'i mbart me vete zhvillimi i lirë i veprimtarisë ekonomike (*shih vendimin nr.28, datë 27.5.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Në rastin në shqyrtim, Gjykata konstaton se ligji nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore” ka përcaktuar se subjekte të detyruar për të vendosur dhe për të përdorur sistemin fiskal, nëpërmjet përdorimit të pajisjeve fiskale, për regjistrimin e pagesave me para në dorë dhe për lëshimin, në mënyrë të detyrueshme, të kuponit tatimor janë tatimpaguesit që kryejnë qarkullimin e mallrave dhe të shërbimeve, për të cilat pagesat nuk kryhen nëpërmjet bankës (neni 55, pika 1) dhe gjithashtu, tatimpaguesit e shitjeve me pakicë, që shesin mallra apo ofrojnë shërbime

në mjedise apo njësi të përhershme, të hapura për publikun (neni 54, pika 3).

19. Ligji parashikon edhe detyrimin e Këshillit të Ministrave për miratimin e karakteristikave teknike e funksionale të pajisjeve fiskale, të sistemit të integruar të kompjuterizuar për transferimet periodike, automatike të deklarimeve financiare, të sistemit të komunikimit, procedurën dhe dokumentacionin për miratimin e tyre, kriteret për pajisjen me autorizim të shoqërive, që ofrojnë pajisjet fiskale, si dhe kushtet e heqjes së autorizimit për këto shoqëri. Për Ministrin e Financave, detyrimi që buron nga ligji ka të bëjë me miratimin e procedurës dhe dokumentacionit për miratimin për përdorim të pajisjeve fiskale, elementet e kuponit tatimor, mënyrën e kontrollit dhe kontrollin e pajisjes fiskale, distancën e ruajtjes së kuponit tatimor dhe rregullat për mirëmbajtjen e tyre teknike e të shërbimit (neni 55, pikat 2 dhe 3).

20. Në zbatim të detyrimeve të mësipërme ligjore, Këshilli i Ministrave dhe Ministri i Financave, përmes vendimit dhe udhëzimit, kanë parashikuar detyrimin e shoqërive të tregtimit të hidrokarbureve dhe shitësve me shumicë për instalimin e sistemit fiskal në çdo kalimatës, regjistrimin e llojit, sasisë dhe vlerës së derivateve të naftës gjatë qarkullimit e shitjes me shumicë të tyre.

21. Gjykata vlerëson se detyrimet që kuadri ligjor dhe nënligjor i trajtuar më sipër përcakton për tatimpaguesit, janë detyrime financiare që përbëjnë burim të të ardhurave që krijojnë buxhetin e shtetit, në referim të nenit 157 të Kushtetutës. Detyrimi kushtetues për të paguar detyrimet tatimore, në vështrim të jurisprudencës së kësaj Gjykate, është vlerësuar se synon të konsolidojnë sistemin buxhetor dhe të përcaktojnë burimet e krijimit të të ardhurave të buxhetit të shtetit. Qëllimi i sistemit tatimor është mirëqenia e përgjithshme, që do të thotë e individëve dhe e komunitetit në përgjithësi, si dhe përmeshja e objektivave sociale të shtetit. Taksat dhe tatimet nuk janë detyrime të negociueshme dhe mblidhen nga organet tatimore, me mënyrat e përcaktuara me ligj. Marrëdhëniet e tatim-taksave janë marrëdhënie ligjore detyrimi ndërmjet shtetit dhe tatimpaguesve dhe, si të tilla, ato mund të përcaktohen vetëm me ligj (*shih vendimin nr.12, datë 28.4.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Në vështrim të standardeve kushtetuese të mësipërme, Gjykata vlerëson se kërkuesi nuk arriti të argumentojë në nivel kushtetues pretendimin se, si rezultat i kontrollit të ushtruar nga shteti dhe barrës financiare që i ngarkohet për shkak të detyrimit për blerjen, instalimin, mirëmbajtjen dhe përditësimin periodik të pajisjeve fiskale, i cenohet liria ekonomike.

23. Si përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesit për cenimin e lirisë së veprimtarisë ekonomike është i pabazuar.

Ç. Në lidhje me pretendimet e tjera

24. Kërkuesi ka pretenduar, gjithashtu, se kufizimi i lirisë ekonomike, në vështrim të nenit 11, pika 3 të Kushtetutës, është bërë pa ligj, se cenohet parimi i sigurisë juridike dhe e drejta e pronës, në kuptim të neneve 4 dhe 41 të Kushtetutës dhe se nuk janë respektuar kërkesat e nenit 118 të Kushtetutës.

25. Bazuar në jurisprudencën e saj (*shih vendimin nr.17, datë 20.7.2008*), Gjykata rithekson se, përderisa nuk konstaton shkelje të parimit kushtetues të lirisë së veprimtarisë ekonomike, nuk ka vend të analizojë kontrollin e përputhshmërisë me Kushtetutën të vendimit të Këshillit të Ministrave dhe të udhëzimit të Ministrit të Financave.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131 shkronja “c” dhe 134, pika 1, shkronja “f” të Kushtetutës; nenit 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri:



VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Xhezair Zaganjori, Vladimir Kristo, Fatmir Hoxha, Sokol Berberi, Petrit Plloçi, Vitore Tusha, Altina Xhoxhaj, Admir Thanza

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.

Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2012, është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 30.3.2012
Doli nga shtypi më 2.4.2012

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2012

Çmimi 28 lekë